

K Ë R K E S Ë

KERKUES: Arledia Shena, e bija e Donald (Dashnor) dhe Besime, lindur më 04.08.1993 në Tiranë dhe banuese në Rruga "Budi", me Adresë kontakti P.Box (Kutia Postare) 1398, C.P (Kodi Postar), Tel. 068 88 77 204.

DREJTUAR: QËNDËS KOMBËTARË TË BIZNESIT

BAZA LIGJORE:

- Neni 202- 208 i K.Pr.Civile.
- Neni 6 i Ligjit nr. 9109 dt.17.07.2003 "Për Avokatinë në Republikën e Shqipërisë",
- Ligji Nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
- LIGJ Nr. 131/2015 Për Qendrën Kombëtare të Biznesit

I/E Nderuar z/znj. !

Kërkuese Arledia Shena është e bija e të ndjerit Donald (Dashnor) Shena, me aktin Dëshmi Trashëgimie Ligjore, me Nr.653 Rep., dhe me Nr.292/13 Kol, datë 08.02.2019, Noter Ermal Xh.Hamzaj, është njohur si trashëgimtare ligjore të tij.

Në mbrojtje të Interesave ligjore të shtetases Arledia Shena kërkojmë nga ana juaj të administroni dhe regjistroni Aktin Dëshmi Trashëgimie, me të dhëna si më sipër.

Sa më sipër,

KËRKOJMË:

Depozitimim dhe regjistrimin e aktit:

- Dëshmi Trashëgimie Ligjore, me Nr.653 Rep., dhe me Nr.292/13 Kol, datë 08.02.2019, Noter Ermal Xh.Hamzaj, lëshuar për të ndjerin Donald (Dashnor) Shena, përkatësisht për subjektet tregtare:
 1. **Nipti:** L71821001T **Emri i Subjektit:** 3 Ds & Af Entertainment;
 2. **Nipti:** L72411034E **Emri i Subjektit:** Albazon ;
 3. **Nipti:** K92306012Q **Emri i Subjektit:** American Capital Group ;
 4. **Nipti:** K12315001P **Emri i Subjektit:** American Global Capital Fund-Investment Worldwide;
 5. **Nipti:** L42220051H **Emri i Subjektit:** American University In Albania ;
 6. **Nipti:** L62427022O **Emri i Subjektit:** Donald Shena ;
 7. **Nipti:** L52215024J **Emri i Subjektit:** Saranda International Airport ;
 8. **Nipti:** L21804062C **Emri i Subjektit:** Vlora International Resort;

si dhe për çdo subjekt tjetër tregtar (Sh.a, Sh.p.k apo P.F) ku shtetasi i ndjerë Donald (Dashnor) Shena është (ortak, asioner, P.F etj.), pa kufizim, duke bërë ndryshimet në të dhënat e subjektit referuar Dëshmisë së trashëgimisë bashkëngjitur.

Bashkëngjitur do të gjeni:

- *Dëshmi Trashëgimie Ligjore, Nr.653 Rep., Nr.292/13 Kol, datë 08.02.2019, Noter Ermal Xh.Hamzaj, lëshuar për të ndjerin Donald (Dashnor) Shena.*
- *Prokurë e Përgjithshme.*

Lutemi të merrni në konsideratë dhe pranoni këtë kërkesë, pasi në të kundërt do të ndiqet rruga ligjore.

Kërkues :

Arledia SHENA
AVOKATE
Nr. Lic. 935
Arledia Shena

Tiranë 13.02.2019



Xhoana P. Omari
NOTERE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NOTERE XHOANA P. OMARI
Nr. 362 Rep.

VËRTETIM NJEHSIMI

Sot më datë 11.02.2019 para meje noteres Xhoana P.Omari, në zyrën time me adresë Rr.“Mine Peza”, P 83/1, Kati 1, Tiranë (në krah të ambasadës polake), u paraqit personalisht:

Av.Elvira Xhemali, Liç Nr.9357, e bija e Ismail-it, lindur më 24.04.1991, në Tiranë dhe banuese në Rr.“Theodhori Kavaljoti”, Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar mbajtëse e Pasaportë me nr.BE6153398 dhe nr.personal J15424070R, e cila kërkon njehsimin e dokumentit të paraqitur:

VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISË SË TRASHËGIMISË LIGJORE- Nr.653 Rep., Nr.292/13 Kol., datë 08.02.2019, Noter Ermal Xh.Hamzaj;

PROKURË E PËRGJITHSHME- Nr. 605 Rep., Nr. 289/3 Kol., datë 30.05.2018, Noter Agron T.Bajri, Tiranë. Bashkëlidhur dokument identifikimi i të përfaqësuarës.

Praktika përmban 15 (pesëbëdhjetë) fletë dhe u fotokopjua nga ana jonë pasi u krahasua me origjinalin për tu përdorur sipas kërkesave të ligjit. Unë noteri, pasi bëra verifikimin e dokumentit origjinal të paraqitur me të fotokopjuarin nga ana jonë, konstatova se dokumenti është origjinal është i rregullt, pa fshirje, korrigjime apo shtesa dhe unë noteri e vërtetoj atë në bazë të Nenit 56 të Ligjit 7829, datë 01.06.1994 « Mbi Noterinë », me ndryshimet përkatëse të pikës 3,4,7 të Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 6291, datë 17.08.2005.

**NOTERE
XHOANA P.OMARI**





REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 653 Rep
Nr. 282 Kol / 13



DESHMI TRASHEGIMIE LIGJORE

Noter Ermal XH. Hamzaj

Sot ne date 08.02.2019 (tete i dyti dymieje e nentembedhjete), ora 14.00 (katermbedhjete), une noteri Ermal Xh. Hamzaj, anetare i dhomes se Noterise Tirane me seli ne Tirane ne Rr” Ismail Qemali”, mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentacionin qe i perket me;

KERKUESJA;

- **Arledia Shena**, e bija e Donald dhe Besime, lindur më 04.08.1993 në Tiranë dhe banuese ne Tirane në adresën: Rr. “Hamdi Sina”, pallati “Rinia 04”, madhore dhe me zotesi juriidike per te vepruar, e identiifikuar me leternjoftimin ID me nr. J35804052C.

OBJEKTI ;

Leshimin e deshmise se trashegimise ligjore te trashegimlensit Donald (Dashnor) Shena .

BAZA LIGJORE ;

Neni 348 te ndryshuar te Kodit Civil, Neni 318, 318/1, 318/2 te Kodit Civil, ndyshuar me ligjin 121/2013, neni 53 e vijues te ligjit 7829 date 01.06.1994 “Per Noterine”ndryshuar me Ligjin 129/2003, miratuar ne daten 29.04.2013 dhe ka hyre ne fuqi ne daten 01.09.2013 .

Ne perfundim te shqyrtimit te kerkeses dhe dokumentacionit ne prani te kerkuesja e cila kerkoi pranimin e kerkeses sipas objektit te saj, une noteri;

VEREJ;

Se kerkuesja eshte vajza e te ndjerit Donald (Dashnor) Shena, i biri i Eqeremit dhe i Trendafile, i datelindjes 06.02.1961, lindur Progonat Tepelene dhe banues ne Tirane ne njesine bashkiake me nr 5, shtetas Shqiptar, mashkull, i martuar, adresa e vdekjes ne Tirane, ne daten e vdekjes 25.05.2018, ndaj ne baze te nenit 32 te Kodit te Procedures Civile ajo ka interes te ligjshem ne kete kerkim, pra legjitimohet te paraqese kerkimin para meje noteres.

Sipas certifikates se vdekjes i ndjeri ne baze te vendimit me nr. 60 date 09.04.2008 te Zyres se Gjendjes Civile njesia 5 Tirane, ka nderruar emrin e tij nga Dashnor ne Donald e regjistruar ne regjistrin themeltar I/Qemali 2/35.

Gjithashtu zyra ime noteriale ne Tirane, ne baze te nenit 53/1 te ligjit 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine" i ndryshuar ka kompetencen tokesore per shqyrtimin e kerkeses pasi vendbanimi i fundit i trashegimlensesit rezulton te kete qene ne Tirane.

Ne lidhje me pretendimin e kerkuesit, para noterit u shtruan per zgjidhje keto ceshtje;

1. Percaktimi i trashegimtareve te trashegimlensesit te kerkuar nga kerkuesja
2. Pjeset takuese te sejcilit prej tyre.

Per te zgjidhur keto probleme, une noterja i referohem nenit 318/2 te Kodit Civil te ndryshuar, i cili ne lidhje me percaktimin e trashegimtareve ligjore te trashegimlensesit dhe pjeset takuese te sejcilit, ben te zbatueshem ligjin e kohes se celjes se trashegimise, referuar rregullimit ligjor ne kohen e vdekjes se trashegimlensesit.

Ne baze te nentit 318/2 te Kodit Civil te ndryshuar trashegimia rregullohet sipas dekretit mbi trashegimine me nr. 1892 date 05.07.1954, ne baze te certifikatave te leshuara nga njesite administrative respektive te trashegimtareve si dhe nga certifikata e vdekjes rezulton se i ndjeri trashegimlensesi ka lene keta trashegimtare ligjor te rradhes se pare

dhe qe trashegojne ne pjese te barabarta sejcili nga 1/5 (nje te pesten) e te gjitha pasurive te luajtshme, te paluajtshme, mjete monetare si dhe cdo pasuri tjeter te cdo lloji pa perjashtim brenda dhe jashte Shqiperise si me poshte;

- **Arledia Shena**, e bija e Donald (Dashnor) dhe Besime, lindur më 04.08.1993 në Tiranë dhe banuese ne Tirane në adresën: Rr. "Hamdi Sina", pallati "Rinia 04"
(Vajza nga martesë e pare me Besime Buqi)
- **Deon Shena**, e bija e Donald (Dashnor) dhe Majlinda, lindur më 10.01.2003, në Tiranë dhe banuese në Tirane ne Rr" Ismail Qemali" pallati Abissnet 7/1
(Vajza nga bashkejetesa me Majlinda Demollari)
- **Erjona Shena**, e bija e Abdullai dhe Sulltane, lindur më 05.09.1980, në Tiranë dhe banuese në Tirane ne Rrugën "Ismail Qemali", Pallati nr. 22
(bashkeshortja)
- **Daisy Shena**, e bija e Donald dhe Erjona, lindur më 14.08.2008, në Tiranë dhe banuese në Rrugën "Ismail Qemali", pallati nr. 22
(Vajza nga martesë me Erjona Shena)
- **David Shena**, i biri i Donald dhe Erjona, lindur më 18.11.2010, në Tiranë dhe banues në Rrugën "Ismail Qemali", pallati nr. 22
(djali nga martesë me Erjona Shena)

Nga hetimi nuk rezulton qe ndonje nga trashegimtarete e mesiperme te kete hequr dore nga trashegimi, te jete shpallur i padenje per te trasheguar me vendim gjykate, apo te jete perjashtuar nga trashegimia e trashegimlensesit

- Gjithashtu nuk rezulton qe trashegimlensesi te kete pasur femije te tjere ne martesë, as te kete pasur femije te tjere jashte martesë, apo te biresuar.



- Kerkuesi me deklaroi se nuk ka trashegimtare te tjere ligjore, pervec atyre te pasqyruar ne trungun familjare dhe te pasqyruara si me lart .
- Shpenzimet noteriale te percaktuara nga urdheri me nr. 306 date 31.07.2013 jane ne ngarkim te kerkueses dhe perbehen nga ato per paraqitjen e kerkeses dhe leshimin e trashegimise ligjore.


PER KETO ARSYE
Une Noter Ermal Xh. Hamzaj

VENDOSA

Pranimin e kerkeses.

Leshimin e Deshmises se Trashegimise ligjore per trashegimlensesit Donald
(Dashnor) Shena duke percaktuar si trashegimtare ligjore te radhes se pare;

- **Arledia Shena**, e bija e Donald (Dashnor) dhe Besime, lindur me 04.08.1993 ne Tiranë dhe banuese ne Tirane ne adresën: Rr. "Hamdi Sina", pallati "Rinia 04"
(Vajza nga martesja e pare me Besime Buqi) .
- **Deon Shena**, e bija e Donald (Dashnor) dhe Majlinda, lindur me 10.01.2003, ne Tiranë dhe banuese ne Tirane ne Rr" Ismail Qemali" pallati Abissnet 7/1
(Vajza nga bashkejetesa me Majlinda Demollari)
- **Erjona Shena**, e bija e Abdullai dhe Sulltane, lindur me 05.09.1980, ne Tiranë dhe banuese ne Tirane ne Rrugën "Ismail Qemali", Pallati nr. 22
(bashkeshortja)
- **Daisy Shena**, e bija e Donald dhe Erjona, lindur me 14.08.2008, ne Tiranë dhe banuese ne Rrugën "Ismail Qemali", pallati nr. 22
(Vajza nga martesja me Erjona Shena)




- **David Shena**, i biri i Donald dhe Erjona, lindur më 18.11.2010, në Tiranë dhe
banues në Rrugën "Ismail Qemali", pallati nr. 22
(djali nga martesë me Erjona Shena)

Te cilët trashëgojne ne pjese te barabarta sejcili nga 1/5 (nje te pesten) e te gjitha
pasurive te luatshme, te paluajtshme, mjete monetare si dhe cdo pasuri tjeter te cdo lloji
pa perjashtim brenda dhe jashte Shqiperise te lena prej trashëgimlensit si dhe detyrimet
sipas pjeseve takuese

- U leshua ne Tirane, sot me date 08.02.2019

NOTERE

Anna King



[Handwritten signature]



KERKESE

Arledia Shena, e bija e Donald dhe Besime, lindur më 04.08.1993 në Tiranë dhe banuese ne Tirane në adresën: Rr. "Hamdi Sina", pallati "Rinia 04", madhore dhe me zotesi juriidike per te vepruar, e identiifikuar me leternjoftimin ID me nr. J35804052C.

OBJEKTI

Leshimin e deshmise se trashegimise ligjore te trashegimlensesit Donald (Dashnor) Shena .

BAZA LIGJORE ;

Neni 348 te ndryshuar te Kodit Civil, Neni 318, 318/1, 318/2 te Kodit Civil, ndyshuar me ligjin 121/2013, neni 53 e vijues te ligjit 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine"ndryshuar me Ligjin 129/2003, miratuar ne daten 29.04.2013 dhe ka hyre ne fuqi ne daten 01.09.2013 .

NOTER

Ermal Xh. Hamzaj

Sikurse rezulton nga certifikata e vdekjes e leshuar nga gjendja civile ka vdekur Donald (Dashnor) Shena ne daten e vdekjes 25.05.2018 .

Trashegimtare ligjore te tij jane;

- **Arledia Shena**, e bija e Donald (Dashnor) dhe Besime, lindur më 04.08.1993 në Tiranë dhe banuese ne Tirane në adresën: Rr. "Hamdi Sina", pallati "Rinia 04"
(Vajza nga martesë e pare me Besime Buqi) .

- **Deon Shena**, e bija e Donald (Dashnor) dhe Majlinda, lindur më 10.01.2003, në Tiranë dhe banuese në Tirane ne Rr" Ismail Qemali" pallati Abissnet 7/1
(Vajza nga bashkejetesa me Majlinda Demollari)

- **Erjona Shena**, e bija e Abdullahi dhe Sulltane, lindur më 05.09.1980, në Tiranë dhe banuese në Tiranë në Rrugën "IsmailQemali", Pallati nr. 22
(bashkeshortja)

- **Daisy Shena**, e bija e Donald dhe Erjona, lindur më 14.08.2008, në Tiranë dhe banuese në Rrugën "IsmailQemali", pallati nr. 22
(Vajza nga martesë me Erjona Shena)

- **David Shena**, i biri i Donald dhe Erjona, lindur më 18.11.2010, në Tiranë dhe banues në Rrugën "IsmailQemali", pallati nr. 22
(djali nga martesë me Erjona Shena)

Te cilet trashëgojne ne pjese te barabarta sejcili nga 1/5 (nje te pesten) e te gjitha pasurive te luatshme, te paluajtshme, mjete monetare si dhe cdo pasuri tjetër te cdo lloji pa përjashtim brenda dhe jashtë Shqipërisë

Ne keto kushte kerkoj qe te me leshohet deshmia e trashëgimise ligjore për te ndërjerit ne baze te nenit 53 te ligjit 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine"i ndryshuar.

Bashkangjitur jane certifikata e vdekjes se te ndërjerit, certifikata e trungut familjar, certifikata e lindjes per sejcilin trashëgimtare

KERKUESJA

Adriana Shena
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
NOTER
AGRONT. BAJRI

Rr. "K.K.Mema", P.2, Shk.1, Ap.3, K.1, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mob.0682121580

Taksa e Nulës
u Pagua



NR. 605 REP.

NR. 289/3 KOL.


PROKURË E PËRGJITHSHMË

Në Tiranë, sot më datë 30.05.2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), para meje Noterit Agron T. Bajri, në zyrën time me adresë: Rr. "K.K.Mema", P.2, Shk.1, Ap.3, K.1, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, u paraqit personalisht:

E përfaqësuar: **ARLEDIA SHENA**- atësia Donald (Dashnor), e dtl. 04.08.1993, lindur në Tiranë dhe banuese në Rr. "Budi", Njësia Administrative nr.1 Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nëpërmjet Letërnjoftimit ID nr.030545935 dhe nr.personal J35804052C, e cila, me vullnetin e saj të plotë e të lirë më kërkoi redaktimin e kësaj Prokure të Përgjithshme konform nenit 70-72 të K.C. si më poshtë vijon:

Unë e përfaqësuar, me anë të kësaj Prokure emëroj si perfaqësues të përgjithshëm *Av. Juxhin Vrenozi*, me Liç.Nr.4140 dhe *Av. Elvira Xhemali*, me Nr.Liç. 9357, të cilët së bashku ose vecmas njëri tjetrit kanë të drejtë dhe kompetenca të përgjithshme për të:

- Më përfaqësuar edhe në mungesën time, para të gjitha organeve të Administratës Shtetërore Qëndrore dhe Lokale, institucioneve private dhe shtetërore, Zyrave të Gjendjes Civile, ZVRPP në Tiranë dhe në të gjithë rrethet, në QKB dhe QKL, në çdo bankë të Nivelit të Parë dhe Nivelit të Dytë që funksionon në Republikën e Shqipërisë si dhe jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, si dhe në çdo insitucion tjetër të pa shprehur më lart për depozitim dhe tërheqje të dokumentave të ndryshme në emër të të ndjerit babait tim Donald (Dashnor) Shena, si individ apo si ortak në çdo Shoqëri Tregtare apo subjekte të tjera të lidhura me të.
- Të nënshkruajnë dhe paraqesin në emrin tim kërkesa, të ngrejnë pretendime, të kërkojnë marrje informacioni, të depozitojnë dhe të tërheqin çdo dokument që do ta konsiderojnë të domosdoshme në të gjitha institucionet kompetente.
- Përfaqësuesit ligjorë kanë të drejtë të emërojnë përfaqësues të tjerë ligjorë apo Studio ligjore brenda Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, duke patur edhe ata prokurë përfaqësimi dhe të më përfaqësojnë pranë çdo Banke të çdo Niveli si dhe për të ushtruar të drejtat dhe kompetencat e përcaktuara në këtë prokurë.
- Përfaqësuesve ligjorë u jap të drejtën e kërkimit të informacionit dhe tërheqjes së dokumentave pranë çdo institucioni, përfshirë spitale private apo shtetërore branda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Përfaqësuesve u jap të drejtën të më përfaqësojnë pranë çdo zyre noteriale me cilësinë e trashëgimtares në lidhje me çdo procedurë për çeljen e trashëgimise ligjore ose testamentare për të ndjerin babain tim Donald (Dashnor) Shena.
- Gjithashtu përfaqësuesve u jap dhe të drejtën për të kërkuar çeljen e testamentit që mund të ketë lëshuar i ndjeri babai im dhe në rast se do të ketë lëshuar, përfaqësuesit kanë të drejtën e nënshkrimit të akteve përkatëse të çeljes e testamentit.
- Përfaqësuesit të dy së bashku ose veçmas, kanë të drejtën e përfaqësimit në të gjithë çështjet civile, administrative, familjare, penale ku unë do të jem në cilësinë e kërkueses, paditëses, të paditurit, të personit të tretë, ndërhyresit kryesor, dytësor, të më përfaqësojnë në çdo lloj pozite procedurale ku unë mund të jem edhe si palë e dëmtuar si dhe të kërkojnë shpërblimin e dëmit etj., para: Drejtorisë dhe Komisariteve të policisë, para Prokurorisë dhe Gjykatave të Rrethit dhe të Apelit në gjithë Republikën e Shqipërisë, Gjykatës Administrative në çdo shkallë, Prokurorisë dhe Gjykatës së Krimeve të Rënda në çdo shkallë, Prokurorisë së Përgjithshme, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatave kompetente në çdo shkallë jashtë Republikës së Shqipërisë, GJEDNj, para të gjithë Institucioneve të Administratës publike dhe private, personave të tretë,




dhe kudo që do të rezultojë e nevojshme, për ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore me qëllim realizimin e interesave të mia në mungesën time.

- Të hartojnë, nënshkruajnë dhe depozitojnë kërkesë padi civile, prapësime, administrative, kundërpadi, memo, apel, rekurs, kallëzim penal, dokumenta noteriale, shkresa dhe kërkesa të tjera pa kufizim duke disponuar lirisht mbi objektin e tyre, të shtojnë dhe të pakësojnë objektin e bërë të kërkueshëm, të paraqesin çdo kërkesë përpara trupit gjykues që ata do t'a çmojnë të ligjshme, të hartojnë dhe depozitojnë kërkesë për rishikim në Gjykatën e Lartë, kërkesa në Gjykatën Kushtetuese me të drejte nënshkrimi në emër dhe për llogarinë time. Kanë te drejte të kërkojnë nga gjykata sigurimin e padisë duke nënshkruar dokumenta në emrin tim.
- Të hartojnë dhe nënshkruajnë kërkesa për lëshimin e Urdhërave të Ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, të paraqiten pranë zyrës së përbarimit për ekzekutimin e tyre, të kundërshtojnë veprimet përbarimore në të gjitha shkallët e gjyqësorit. Të paraqesin ankim të veçantë apo përfundimtar, të paraqesin prova në gjykim që kanë të bëjnë me rrethanat lehtësuese, sqaruese apo personalitetin tim, të kërkojnë thirrjen e dëshmitarëve, të kërkojnë caktimin e ekspertëve, të kërkojnë përjashtimin e gjyqtarëve ose prokurorëve si dhe çdo të drejtë tjetër procedurale për çdo çështje gjyqësore në ngarkimin tim.
- Të më përfaqësojnë para çdo organi administrativ, zyrë noteriale, operatorë të tjerë apo persona e subjekte private dhe të kryejnë çdo veprim që do ta konsiderojnë të arsyeshëm në emrin tim.
- Të paraqiten dhe të më përfaqësojnë në të gjitha organet shtetërore apo private, persona fizik apo juridik, për të tërhequr apo depozituar dokumentacionin përkatës që ata do ta çmojnë të arsyeshëm në lidhje me çdo çështje juridike civile, penale apo administrative që ka lidhje me mua dhe të ndjerin babain tim.
- Përfaqesuesit kanë të drejtën e aplikimit pranë Zyrave të Regjistrimit të Pasurive brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, QKB, institucioneve të tjera private apo shtetërore për t'u pajisur me çdo lloj dokumenti që ata do ta çmojnë të arsyeshme, përfshirë kartelë pasurie, çertifikatë pronësie, marrje informacioni apo të hartojnë kërkesa për të mbrojtur interesat e mia etj.
- Kanë të drejtë të më përfaqësojnë, nënshkruajnë, hartojnë dhe të ndjekin të gjitha procedurat për të kërkuar pavlefshmërinë e çdo lloj akti që bie ndesh me interesat e mia, të kërkojnë shpërblimin për demin e shkaktuar ndaj meje si pasojë e veprimeve të individëve apo organeve shtetërore etj.
- Kanë të drejtë të kundërshtojnë çdo akt të paligjshëm të nxjerrë nga organet shtetërore apo private që janë në kundërshtim me interesat e mia.
- Të kryejnë çdo veprim tjetër material dhe procedural që ndonëse nuk është përmendur shprehimisht në këtë prokurë i shërben qëllimit për të cilën është lëshuar prokura, në ndjekje të të gjithë procedurave administrative apo gjyqësore lidhur me zgjidhjen përfundimtare të çështjeve në mbrojtje të interesit tim dhe në cilesinë e trashëgimtares ligjore të të ndjerit babait tim Donald (Dashnor) Shena.

Kjo prokurë ka fuqi ligjore deri në përfundimin e plotë të porosisë sime ose me shfuqizimin e saj me akt noterial. Të gjitha veprimet që do të kryejnë Përfaqësuesit e emëruar në emër dhe për llogarinë time i konsideroj të mirëqena njësoj sikur të kem qenë vetë prezente në çdo moment dhe ti kem kryer vetë ato. Efektet e kësaj Prokure do të fillojnë nga data e nënshkrimit të saj. Prokura redaktohet në 5 (pesë) kopje origjinale, me përmbajtje dhe vlerë të njejtë juridike. Pas përpilimit, prokura i lexohet të përfaqësuarës, e cila e kuptoi, pranoi përmbajtjen e aktit dhe e nënshkroi atë pa vërejtje, duke vënë emrin e mbiemrin, formë nënshkrimi kjo e përcaktuar në nenin 46 të Ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" (i ndryshuar). Unë, Noteri, vërtetoj redaktimin korrekt të aktit dhe autenticitetin e nënshkrimit, në bazë të ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" (i ndryshuar).

E PËRFAQËSUARA
ARLEDIA SHENA

Arledia Shena



NOTERI
AGRON T. BAJRI

Agron T. Bajri